

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SI PRODHOHET NJË KONSPIRACION?
ADRESA	https://www.cna.al/opinione/si-prodhohet-nj-konspiracion-i475222
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 19:43:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 19:28:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bef37529e48ede42de8d5f37eae5d36c5d1b974960de0193655aeb808b479dd
TEKSTI	29cb07807c5fb8f66cae81d9e11fd14fbb9cc1ccefc239039ea15640a417b5628
PAMJA	d4eecf5c24c3250b65afc19fef5d125e5bd45923235f21270a6612502a5f32cd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	092c1376fd2f4e0e52c1fa5dc30fa9dce407e2d2d639b892802841089467d037
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/092c1376fd2f4e0e52c1fa5dc30fa9dce407e2d2d639b892802841089467d037>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x


21:09 Aktualitet

Me votim të hapur dhe unanim, anëtarët e Këshillit Bashkia...

SI PRODHOHET NJË KONSPIRACION?



25 Shtator 2026, 21:28, Opinione Erion Dasho



Konspiracioni i radhës është se Parlamenti Evropian ka konfirmuar se me vaksinat kundër COVID-it është organizuar një "lilotari" ku disa të vaksinuar kanë marrë doza me përqendrim të ulët, ndërkohë të tjerët kanë marrë doza "vdekjeprurëse".

Konspiracioni origjinal vjen nga Australia. Është iuriist dhe shkruan për gjithëka që prodhon "lajm" duke nisur nga vaksinat dhe duke e mbullur me luftën në Ukrainë (sigurisht duke

mbështetur versionin pro-rus të ngjarjeve).

Le ta nisim duke ndarë propagandën nga faktet. Është e vërtetë se eurodeputeti Marcel de Graaff ka shtruar disa pyetje në Parlamentin Europian lidhur me ndryshimet midis loteve të vaksinave, të dhënat e efekteve anësore dhe transmetimin e COVID-it. Këto pyetje e kanë bazën tek një studim danez që gjeti variacione midis disa loteve të vaksinave anti-COVID të marra në shqyrtim.

Edhe njëherë, artikulli në fjalë raporton se ka dyshime për variacion midis loteve dhe se këto dyshime duhen studiuar më tej, para se të konfirmohen. Deputeti ka të drejtën e vet që bazuar në studimin në fjalë të ngrejë pyetje dhe të kërkojë hetim të hollësishëm mbi gjetjet, çka në fakt e kërkojnë edhe vetë autorët.

Po konspiracionistët?!

Këta nuk kanë asnjë dyshim!

Mjafton që një eurodeputet ngre një pikëpyetje dhe konspiracionistët i vënë vulën "fakteve" të mëposhtme:

- dikush ka prodhuar qëllimisht një "dozë vdekjeprurëse" të vaksinës;
- njerëzit janë ndarë në mënyrë sekrete në grupe për një eksperiment çnjerëzor;
- EMA ka zbuluar një komplot dhe më pas e ka fshehur, etj., etj.

Dhe "kryepërfundimi" është se ndodhemi përpara një "krimi kundër njerëzimit"!!!

E kam përsëritur me dhjetëra herë në postime, artikuj dhe intervista se një efekt anësor i raportuar pas vaksinimit nuk do të thotë automatikisht se efekti në fjalë është shkaktuar nga vakcina.

Nëse dikush pëson infarkt, insult apo vdes pas vaksinimit, ngjarja regjistrohet dhe raportohet. Më vonë kryhet hetim i thelluar profesional për të kuptuar nëse ky efekt anësor është shkaktuar ose jo nga vakcina.

Le të jap për të disatën herë një shembull. Fakti që në verë shiten më shumë akullore dhe mbyten më shumë njerëz duke u larë në det, nuk do të thotë se akulloret janë shkaktare të mbytjeve. Por, për një konspiracionist anti-akullore ky "fakt" do të mjafton për t'i shpallur akulloret "vrasëse".

Kjo është arsyeja pse një grafik efektesh anësore të raportuara nga sistemet VAERS nuk provon se këto dëme janë shkaktuar nga vakcina. Lidhja mund të jetë po aq e "fortë" sa edhe lidhja midis akulloreve dhe mbytjeve në det.

Dhe nëse dikush pretendon se ka prova për një "vaksinë vdekjeprurëse", le të publikojë të dhënat, metodologjinë dhe analizën statistikore dhe jo titujt bombastikë dhe mashtrimet e sharlatanëve të çdo cepi të globit.

Ka ardhur, madje ka kaluar, koha që shoqëria të veprojë kundër konspiracionistëve që nuk lënë rast t'u shpëtojë pa ngjallur frikë e panik...



CNA

08:03 | 26 shtator

Informohuni!
cna.al
Pacensurë!

AKSIDENTI NË FUSHË-KRUJË

CNA.AL RAMA AKUZA NGA NEW YORK-U
"Joe Biden tradhtoi Hashim Thaçin"

ndryshe

Pas transferimit të rezervave të arit të pastër, pronë e shtetit rumun, Rusia aplikoi mbajtjen peng të tij

MOTI SOT
VLORË: 14° / 23°





Të sugjeruara

Një spiune me moralin e Vlora Hysenit

Ish-shefja e SHISH nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj

VLORE MOJ NUR I PUSHTETIT

Skandal pas skandali/ Një palo shtet anëtar i NATO-s

Po tani, kush do ta shpëtojë Shqipërinë nga turpërimi?!

TRADHËTIA NDAJ SHTETIT

Kur kryeministri është edhe president dhe presidenti ndihmës i kryeministrit

Tani i Madh, Topi i Madh

Patriotët selektivë të patriotizmit selektiv

Disa sugjerime për konstatim të përbashkët të gjendjes pas Aktgjykimit të 16 shtatorit

Horizonti i Elbasanit

TË RROFTË EMRI...

Orët e Tiranës

Reklam dhe Propagandë të ish-ambasadës së Shqipërisë

[Demi si kom te kesu sukses ne shqipëri:](#)

[Bojkotoni takimet me politikanët e Shqipërisë që mbajnë peng demokracinë!](#)

[Kurbani i fundit për Kosovën/ Drejtësia e lups politike dhe dora e historisë](#)

[Tirana pa kokë dhe medikamenti i kryeministrit](#)

[Dy fjalë të fundit për histerinë folklorike kundër ngritjes së Muzeut Hebraik në Vlorë](#)

[Ekspertët zbulojnë shtatë sjellje të çuditshme që mund të lidhen me inteligjencën e lartë](#)


[Dëgjimet komuniste të Ramës për Reformën Territoriale](#)

[editorial](#)

09:11 Editorial Bujar Leskaj

[Të ndihmojmë SHISH-in të mbrojë shtetin nga krimi, dhe jo krimin nga shteti!!](#)

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

[Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH](#)

[opinion](#)

21:28 Opinione Erion Dasho

SI PRODHOHET NJË KONSPIRACION?

20:15 Opinione Ilnisa Agolli

Një spiune me moralin e Vlora Hysenit

13:10 Opinione Lorenc Vangjeli

Ish-shefia e SHISH nuk shantazhoi median. nor kërcënoi armintë e sai

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.